

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX OPTIFLEX® 2K

Hidroizolues, 2 komponentësh




Fushat e përdorimit

Për ngjitjen e pllakve izoluese në xokolaturën (EPS-P, EPS-S, XPS-R) në shtresa bitumi. Mbushës ngjitës me çimento / shpërndarës dy përbërës dhe veshja mbrojtëse për zonën e bazamentit dhe nëntokës. I përshtatshëm për të gjitha sistemet e pastrimit. BELIT është perkufizimi mineralogjik i disilikatit të kalciumit, i fazes së parë të materjaleve lidhës të të gjitha gelqereve hidraulike s dhe të të produkteve RÖFIX BELIT. Materjali lidhës që digjet në furnalë me temperaturë +1100 °C i perkon termit historik Cimento Romake ose Gelqere Romake, i cili në vitin 1900 filloi të kishte një përdorim të gjere për punime të ndryshme në fasada, monumente etj., në të gjitha pjesët e Evropës dhe USA para ndryshimeve që erdhën nga shpikja e cimentos së portlandit. Kolla me ngjyrë RÖFIX është e përshtatshme për fuga me një gjerësi deri në 3 mm. Bojë neutralizuese RÖFIX redukton aftësinë thithëse të bazamenteve minerale. Në rast hollimi nuk ka rrezik të formohen shtresa ndarëse.

Karakteristikat

- I papërshkueshëm nga uji në gjendje të montuar deri në 8 m shtyllë uji
- Rezistent ndaj rrezeve UV
- Rezistent ndaj ngrirjes dhe kripës
- mbulon çarje në nënshtresë deri në 0,2 mm
- Me qëndrueshmëri ndaj temperaturave dhe vjetërimit
- Qëndrueshmëri edhe në sipërfaqe të pjerrëta
- Rezistent ndaj ujit me gelqere
- Rezistent ndaj dëmtimeve mekanike

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	18349
EAN	9003304183494
Paketimi	
Sasi për njësi	20 kg/Nj.
Njësi për paletë	18 Nj./Pal
Ngjyra	gri
Konsumi	rreth. 1,5 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 980
Trashësia minimale e suvasë	2 mm
Dendësia bruto	rreth. 1600 kg/m ³

RÖFIX OPTIFLEX® 2K

Hidroizolues, 2 komponentësh

Numri i artikullit	18349
Trashësia e shtresës	0-2 mm
Kapaciteti termik	rreth. 1,12 kJ/kg K
Temperatura e nënshtresës	5-30 °C

Baza e materialit

- Dy komponentësh
- Lidhës dispersiv
- Çimento

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu. Një garanci për tharje pa njolla nuk mund të jepet për shkak të kushteve të ndryshme të motit dhe objektit. Për shkak të përdorimit të lëndëve të para natyrore mund të vërehen ndryshime të vogla ne ngjyra. Në rastin e veshjeve që ende nuk janë tharë plotësisht, ekspozimi ndaj ujit (p.sh. vesa, mjegulla, shiu) mund të çlirojë substanca ndihmëse nga veshja dhe të grumbullohet në sipërfaqe. Megjithatë, një shtresë shtesë bojë mund të parandalojë çdo ndryshim të dukshëm të ngjyrës.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blozë, kripra etj. . Bazamentet duhet të mos kenë tendosje dhe devijime forme. Marrja e lagështisë të pjesevë të murit nga brënda ose nëpërmjet lagështisë në rritje duhet të evitohet. Te gjithë izoluesit horizontal dhe vertikal të lagështisë duhet të jenë disponibël.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Bazamente me aftësi të lartë thithëse duhet të lyen paraprakisht me fortësuesin RÖFIX, në mënyre profesionale. Fugat konstruktive nuk lejohet të suvatohen. Në këtë rast duhet të vendosen profile fugash, për të cilat duhen mbajtur parasysh normat e prodhuesit.

Përgatitja

Komponentin pastoz A bashkoheni të tërin me komponentin pluhur B në një përzierës mekanik derisa të arrini një masë homogjene, pa kokrriza. Sipas nevojës së përdorimit dhe përpunimit, produkti mund të sillet në konsistencën e tij duke përdorur ujë të pastër dhe të ftohtë. Gjatë përdorimit si ngjitës, nuk është i nevojshëm shtimi i ujit. Bëni rrafshimin dhe fërkimin e sipërfaqes së izoluar. Gjatë rrafshimit mos hidhni ujë. Gjatë fërkimit bëni hollimin me 2 litra ujë/20 kg Thes (max. 10 %), tek sipërfaqja e sapo hidroizoluar.

Këshilla për përpunimin

Koha e përpunimit rreth 30 min Produkti thahet hidraulikisht dhe fizikisht. Koha e tharjes varet nga temperatura dhe lagështia relative e ajrit. Në lagështi të larta relative dhe temperatura të ulta, tharja mund të vonohet me ditë. Mos e përpunoni në temperatura të ajrit dhe të sipërfaqes nën +5 °C ose mbi +30 °C të. Materialin që do ngurtësohet, mos e holloni apo përpunoni me tej. Veglat e punës mbas përdorimit pastrojeni me ujë, në gjëndje të thatë, vetëm një eliminim mekanik i papastërtive është i mundshëm. Prospekti Sistemet e termoizolimit në zonat e bazamentit dhe në zona toke të qeta nga shoqata profesionale WTM e.V. duhet marrë parasysh patjetër. Masa e izolimit nëse është në kontakt me tokën duhet të mbrohet nga dëmtimet (apo të ngjashme) me anë të një qese mbrojtëse me topa. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Nëse shpërhapni me furçë, hollojeni me max. 10% ujë

RÖFIX OPTIFLEX® 2K

Hidroizolues, 2 komponentësh

Përpunimi

Si masë ngjitëse: Për zonat e bazamentit dhe ato perimetrike, llacin ngjitës shtrojeni në të gjithë sipërfaqen me një mistri të dhembëzuar 10x10 ose me metoden e ngjitjes me shirita anash (reth 60 % të sipërfaqes të ngjitjes) në anën e pasme të pllakave izoluese. Pllakat izoluese duhen ngjitur në njëtrajtshmëri me planin dhe të puthitura mirë, në pikën e lidhjes. Pllakat izoluese duhen fiksuar me tiplla në zonën e bazamentit, mbas forcimit të masës ngjitëse me minimumi 2 kunjat për pllakë (4 kunjat për m²). Kunjëzimi duhet aplikuar mbasi ngjitësi të jetë tharë mirë. Koha e tharjes rreth 3 ditë/10mm shtresë (+20 °C /65 % r.F./temperatura e pjesës së ndërtimit +15 °C/bazamenti thithës).

Largoni letrën mbrojtëse nga shiriti vetëngjites-PE dhe ngjitëni në të njëjtën pedencë dhe distancë me profilin e kornizës, duke e shtypur fort me gishtat nëpër cepa. Ripërtëritësi i bazamentit RÖFIX duhet shtruar me anë të një furçe ose me sprucim, i holluar me ujë në raportin 1 me 1. Në rat nevojë imprenjoheni edhe 1x tretësirë të paholluar të ripërtëritësit të bazamentit. Më pas shtroni RÖFIX 671 përkatësisht RÖFIX 640 „ftë reskët mbi të freskët“ Si masë ngjitëse për profilet e dekorit: Ngjitëni gjithmonë në të gjithë sipërfaqen. Profilet presojini mirë dhe ngjitësin sipas mundësisë shtrojeni në forma kanalesh. Edhe në pikat e puthitjes shtrojeni në të gjithë sipërfaqen dhe presojini pjesët fort. Shtroni aq ngjitës sa mund të perpunoni brënda perjudhës së përcaktuar të punimit.

Malla 2 herë

Si mbrojtës ndaj lagështirës në sistemin e termoizolimit dhe sistemin e suvave në zonën e tokës: RÖFIX OPTIFLEX 2K aplikohet nga rreth 5 cm (Austri) mbi vijën e sipërme të mbaruar deri në fund të pllakës së xokolaturës dhe aplikohet në sistemin e suvasë si shtresë e jashtme. Duhet të respektohen standardet kombëtare.

Perforcimi i pllakave izoluese: Llacin izolues, shtrojeni, rreth 2-3 dite mbas ngjitjes (në varesi të kushteve atmosferike apo kunjëzimit të përdorur), në trashësinë specifike 2,5 mm dhe kreheni me RÖFIX R12 me dhembëza.

Magazini

Magazinojini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë.

Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skemat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.